

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit R.LLC me seli në Prishtinë,ndaj të të paditurës M. C. sh.p.k me seli në fshatin P. Komuna e F.,në praninë e të të autorizuarit me shkrim N. S. i cili e përfaqësoj palën paditëse dhe në mungesë të palës së paditur),lidhur me pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme prej;12.407,00 euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;22.05.2015,ndërsa me datën;29.05.2015 merr këtë:

A K T V E N D I M

Shfuqizohet aktvendimi për lejimin e përmbarimit E.nr.693/2013 i datës;13.08.2013 pas kundërshtimit të palës debitore të ushtruar ndaj propozimit për përmbarim të palës kreditore,ndërsa pas vazhdimit të kontestit të rregullt civil gjykata merr këtë;

A K T G J Y K I M

Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. LLC me seli në Prishtinë .

I.Detyrohet pala e paditur M. C. sh.p.k me seli në fshatin P. Komuna e F.,që ti paguaj palës paditëse shumën e përgjithshme prej;1.600,00 euro (njëmijë e gjashtëqind euro),në emër të borxhit kryesor lidhur me transportimet e mallërave,me kamatë ligjore prej 4%,duke filluar nga data 01.06.2013 si datë e arritjes për pagesë të faturës deri në pagesën definitive të borxhit,në afatin paritiv prej 7 (shtatë) ditëve,të gjitha këto nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.Refuzohet në tërësi si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së palës paditëse për shumën prej;10.807,00 euro.

III.Detyrohet pala e paditur që ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore,palës paditëse në shumë prej;1.227,20 euro,duke llogaritur nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim .

A r s y e t i m

Pala Kreditore R. LLC në Prishtinë me datën;01.08.2013 ka parashtruar pranë kësaj gjykate propozimin për përmbarimin lidhur me pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme prej;12.407,00 euro ndaj palës debitore M. C. sh.p.k me seli në fshatin P. Komuna e F.,duke kërkuar në të njëjtën kohë nga kjo gjykatë aprovimin e tij duke e detyruar palën debitore bartjen e mjeteve të saj në xhirollogarinë e palës kreditore.

Gjykata me rastin e pranimit të këtij propozimi ka lejuar të njëjtin me datën;13.08.2013 duke e njohtuar palën debitore lidhur me detyrimin e tij që rrjedh nga ky propozim.Mirëpo pala debitore në afatin ligjor konkretisht me datën;30.08.2013 ka parashtruar kundërshtimin ndaj këtij propozimi duke u arsyetuar në faktin se ndaj kreditorit nuk ka detyrim ashtu si thuhet në propozimin e tij për përmbarim,porn ë të njëjtën kohë pranon borxhin në shumën prej 1.600,00 euro në emër të transportimit të dy kontejnerëve të mallit nga Durrësi në Prishtinë.

Pas pranimit të kundërshtimit të palës debitore kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore dhe pastaj edhe seancën e shqyrtimit kryesor duke shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit dhe duke vazhduar me zhvillimin e kontestit të rregullt civil bazuar në dispozitat e nenit 58 paragrafi 4 të LPK-së, në të cilat janë deklaruar edhe palët ndërgjyqëse duke i shprehur pretendimet e tyre lidhur me këtë çështje juridike.

Paraprakishtë i autorizuari i palës paditëse i ka propozuar gjykatës mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor në mungesë të palës së paditur pasi që i njëjti nuk e ka arsyetuar mosradhjen e tij (të cilin propozim gjykata e ka aprovuar), ndërsa në vazhdim ka deklaruar se ka mbetur në tërësi pranë kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata aprovimin e saj për shumën prej; 12.407,00 euro, lidhur me shërbimet e kryera për transportimin e mallërave për palën debitore.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së palës paditësenë pikën numër një të dispozitivit të këtij aktgjykimi si të bazuar, gjykata paraprakishtë është bazuar në pohimin e borxhit nga pala e paditur, ndërsa lidhur me refuzimin e pjesës së kërkesëpadisë së palës paditëse për shumën prej; 10.807,00 euro është bazuar në dispozitën e nenit 506 të LPK-së, pasi që pala paditëse me asnjë provë të vetme nuk ka dëshmuar pretendimin e saj lidhur me borxhin e pretenduar pasiqë faturat e prezantuara në gjykatë nuk janë të nënshkruara dhe as nuk janë të vulosura nga pala e paditur, ndërsa pretendimi i palës paditëse për pagesën e fletëngarkesës së anijës (bill of loading) kjo për gjykatën është provë e palejuar pasiqë e njëjta nuk është e përkthyer në gjuhën zyrtare të gjykatës dhe si të tillë gjykata e ka hudhur poshtë si të palejuar.

Duke vendosur lidhur me zbatimin e të drejtës materiale në këtë çështje juridike, gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 506 të LPK-së si dhe në dispozitën e nenit 262 të LMD-së, në të cilën është precizuar kjo të përgjegjësia debitorit kundrejt kreditorit nga e cila dispozitë rrjedh detyrimi i debitorit në mënyrë decisive "kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij, kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonon me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak."

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me çmuarjen e të gjitha provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse është bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës.

Lidhur me vendosjen e afatit parativ për pagesën e shumës në të holla që rrjedh nga dispozitivi i këtij aktgjykimi gjykata është bazuar në nenin 509 pika e të Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës.

Duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, duke aprovuar shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej; 1.227,20 euro dhe atë si në vijim; për hartimin e propozimit për përmbarrim shumën prej; 208,00 euro, për hartimin e parashtrësës së datës; 04.12.2014 shumën prej; 208,00 euro, si dhe për pjesëmarrje (si përfaqësues i autorizuar) në tri seanca shumën prej; 811,20 euro (270.20 x 3).

Gjykata pas analizimit dhe shtjellimit të kësaj çështje juridike, ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën e nenit 262 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 506 dhe nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
C.nr.474/2013, me dt;29.05.2015

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.